



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

POLICISKI INSPEKTORAT KOSOVA POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajvali - Prishtinë



Nr./Br. 03-116-192/3

Data / Datum 11-03-2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



Referencë: IPK/10032025/DI

Datë: 10.03.2025

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (ZKM) nr. 03/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për Procedurën e Planifikimit, Inspektimit dhe Raportimit, Departamenti i Inspektimit nxjerrë këtë:

RAPORT INSPEKTIMI

Objekti	- Menaxhimi i punësimit dytësor në Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Kufirit - Gjilan
Arsyet e inicimit	- Me kërkesë të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave, me datë 10.02.2025, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Kushtrim Hodaj ka autorizuar Departamentin e Inspektimit që të realizojë një inspektim të jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar praktikën e punësimit të punonjësve policor në detyra dytësore. Më 28.01.2025, IPK ka pranuar një ankesë, sipas së cilës janë duke u aplikuar praktika favorizuese në fushën e punësimit dytësor në Stacionin Policor të Mbikëqyrjes së Kufirit - Gjilan. Është pretenduar të ketë praktika të padrejta në angazhimin e personelit në punë dytësore, favorizime në caktimin e personelit dhe tejkalim të angazhimit në raport me kufizimet. Sipas të njëjtit, praktikën e tilla janë në kundërshtim me rregullat dhe procedurat në fuqi, dhe mund të sjellin pakënaqësi dhe rënie të motivit për punë në radhët e strukturës në fjalë. Inspektimi ad hoc ka ofruar mundësi për t'u njohur me respektimin e rregullave dhe procedurave të punësimit dytësor, po ashtu dhe me respektimin e parimit për mundësi të barabarta dhe mos diskriminim.
Objektivat	- Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave të punësimit dytësor, - Vlerësimi i respektimit të parimit për mundësi të barabarta e mos diskriminim.
Metodologjia	- Gjatë realizimit të punës inspektuese, është përdorë metodologjia si në vijim: (a) Janë realizuar takime me drejtues dhe bartës të funksioneve, si në vijim: - Shefin e Sektorit të Operativës (SPMK - Gjilan), - Mbikëqyrësin e Ekipit A; (b) Janë kryer kontrole (këqyrje apo verifikime): - të angazhimit të personelit në punë dytësore; (c) Janë marrë dokumente, si: - Orari mujor dhe oraret ditore (Janar 2025), - Vendimet për punësimet dytësore, - Marrëveshja e palëve për zbatimin e autorizimeve policore, - Raportet e angazhimit në punë dytësore (Tetor 2024 - Janar 2025).
Subjekti	- Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit - Gjilan.
Afatet	- Inspektimi ka filluar më 13.02.2025 dhe ka përfunduar në po të njëjtën ditë.
Kriteri i vlerësimit	- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, - Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2023 për Marrëdhënien e Punës.
Përgatitur nga	- Xhavit Fetahaj, inspektor
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
Datë	- 10.03.2025



Gjetjet

1. Në Shtator të vitit 2024, Njësia për Punë Jashtë Detyrës Zyrtare dhe Punë Dytësore në Drejtorinë e Personelit (Divizioni i Personelit dhe Administratës - Departamenti i Burimeve Njerëzore) ka angazhuar menaxhmentin e Stacionit Policor të Mbikëqyrjes së Kufirit - Gjilan, që të interesohet nëse ka punonjës të interesuar nga Policia Kufitare për të realizuar Kërkesën e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë, për të ofruar shërbimet e sigurimit të personelit dhe pronës në Deponinë Sanitare në Fshatin Velekincë (Gjilan). Pas vlerësimit të kërkesave dhe të kapaciteteve të mundshme, është shprehur gatishmëri nga një numër punonjësish, për të ofruar shërbime të sigurisë në këtë deponi, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron baza ligjore për punësimin dytësor. Më 16 tetor 2024, është nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë dhe Policisë së Kosovës, për mbajtjen e rendit e qetësisë publike, dhe sigurimin fizik të hapësirave në Deponinë sanitare në Fshatin Velekincë - Gjilan. Person kontaktues nga Policia e Kosovës është caktuar Mbikëqyrësi i Ndërrimit "A" në kuadër të SPMK - Gjilan, që më pas edhe ka menaxhuar me mbarëvajtjen e shërbimeve dhe angazhimit të personelit.

2. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2023 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës ka rregulluar punësimin dytësor që nënkupton "angazhimin e zyrtarëve policor jashtë punës së rregullt, sipas marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet Policisë dhe organizatave, apo institucioneve tjera ku kërkohet zbatimi i autorizimeve policore". Sipas nenit 40 të Udhëzimit, zbatimi i këtyre autorizimeve, përfshinë disa fusha, duke mos u kufizuar vetëm në: kontrollimin e komunikacionit dhe sigurinë e këmbësorëve, kontrollimin e masës, sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe pronës, zbatimin rutinor të ligjit për autoritetet publike. Sipas SPMK - Gjilan, numri i punonjësve të përfshirë në punë dytësore ka ndryshuar vazhdimisht dhe shërbimet e sigurisë janë ofruar nga një pjesë e personelit të Stacionit dhe strukturave tjera të DRPK- Lindje. Po ashtu, duke iu referuar të dhënave në tabelë, pasqyrohet një ngritje e numrit të orëve nga muaji në muaj. Duke pasur parasysh se shërbimet e sigurisë në Deponi kanë filluar nga data 21 Tetor 2024, për këtë arsye numri i orëve të realizuara gjatë këtij muaji është më i vogël.

Indikatori	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Totali
Numri i orëve të realizuara	496	1.440	1.452	1.488	4.380
Numri i zyrtarëve të angazhuar	33	41	46	52	139

3. Për t'u lejuar angazhimi në punë dytësore, sipas nenit 42 të Udhëzimit, punonjësit e interesuar duhet të ushtrojnë kërkesë në formular përkatës, që më pas i nënshtrohet procedurës së aprovimit nga Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë. IPK-ja është interesuar të njihet me faktin nëse personeli i angazhuar e ka pasur të lejuar punësimin dytësor në kohën kur janë realizuar shërbimet e sigurisë në këtë Deponi. Nga gjithsej 4.874 orë të realizuar gjatë periudhës Tetor 2024 - Janar 2025, pasqyrohet se 680 prej tyre (14%) janë realizuar në ditët kur zyrtarët policor nuk kanë qenë të pajisur me vendime nga Drejtoria e Personelit. SPMK - Gjilan pasqyron se:

- Gjatë Tetorit janë angazhuar 33 zyrtarë policor në punë dytësore, ku 23 prej tyre, pa vendime kanë realizuar 71% të orëve të përgjithshme të muajit,
- Gjatë Nëntorit janë angazhuar 41 zyrtarë policor në punë dytësore, ku 18 prej tyre, pa vendime kanë realizuar 16% të orëve të përgjithshme të muajit,
- Gjatë Dhjetorit janë angazhuar 46 zyrtarë policor në punë dytësore, ku 1 prej tyre, pa vendim ka realizuar 2% të orëve të përgjithshme të muajit, si dhe
- Gjatë Janarit të këtij viti janë angazhuar 52 zyrtarë policor në punë dytësore, ku 4 prej tyre, pa vendime kanë realizuar 5% të orëve të përgjithshme të muajit.

Indikatori	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Totali	Përqindja
Numri total i orëve	496	1.440	1.452	1.488	4.874	100%
Numri i orëve me vendime	144	1.216	1.420	1.416	4.194	86%
Numri i orëve pa vendime	352	224	32	72	680	14%

4. IPK-ja është interesuar të njihet me praktikat e aplikuara në Stacion, të angazhimit të personelit të uniformuar në punë dytësore. Sipas drejtuesve të Stacionit, hartohet orari mujor i angazhimit në punë të rregullt, kurse mbi këtë bazë për çdo ditë hartohet edhe orari ditor, që mund të ndryshoj nga ai mujor për shkak të dinamikave dhe aktiviteteve të paparashikuara. Kjo situatë pamundëson krijim të një listë me renditje të personelit që mund të angazhohet në punë dytësore. Kjo lë të nënkuptohet se angazhimi në punë dytësore bazohet varësisht prej kërkesave të palëve nënshkruese të marrëveshjeve për shërbime policore dhe disponueshmërisë së personelit të lirë dhe të pa caktuar në orar të rregullt të punës. Për të hequr dilemat nëse mund të ketë favorizime në caktimin e zyrtarëve në punë dytësore, IPK ka verifikuar raportet për katër (4) muajt e fundit të angazhimit të personelit në punë dytësore, por krahasimet dhe analizat i ka bërë për tre muajt e fundit, meqenëse muaji Tetor nuk ka qenë i plotë. Sipas të dhënave, derivon një mesatare prej rreth 32 orë në muaj për zyrtar, të përfshirë në punë dytësore (mostra ka përfshirë 53 zyrtarë që kanë qenë aktiv). Duke marrë parasysh këtë mesatare pasqyrohet përfshirje e një numri zyrtarësh në punë dytësore, nën/mbi këtë mesatare, duke iu ofruar mundësi disave prej tyre që të përfitojnë më shumë krahasuar me zyrtarë të tjerë. Janë identifikuar 18 nga 53 zyrtarë që kanë realizuar punë dytësore mesatarisht mbi 32 orë në muaj. Është evidentuar një rast kur zyrtari policor mesatarisht ka arritur të përfshihet dallueshëm në punë dytësore në krahasim me të tjerët, tek i cili për tre muaj silltet një mesatare prej 83 orë (në Nëntor - 88 orë, në Dhjetor - 80 orë dhe në Janar - 80 orë).

Tabela 3 - Pasqyrë përmbledhëse e numrit të përfituesve nga puna dytësore në raport me kuotat (grupet) e orëve të realizuara (Nëntor 2024 - Janar 2025)

Orë	9-16	17-24	25-32	33-40	41-48	49-56	57-64	65-72	73-80	81-88
Nr.	4	16	15	12	2	3	0	0	0	1

5. Sa i përket kufizimeve të punës dytësore, Udhëzimi në nenin 41, pika 1 përcakton që të “punësuarit në Polici nuk mund të angazhohen në punë dytësore, derisa nuk e kanë përfunduar me sukses periudhën e punës provuese”. Kontrolli i dosjeve dëshmon se nuk është hasur asnjë zyrtar që të jetë angazhuar në punë dytësore. Përveç këtij kufizimi, Udhëzimi në nenin 41, pika 3 përcakton edhe disa kufizime shtesë, sipas të cilave, “të punësuarit në Polici nuk mund të angazhohen në detyrë dytësore kur gjenden në masën e suspendimit dhe kur ka rekomandim nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore për lirim nga sforcimet fizike”. Edhe nga këto kategori, IPK nuk ka hasur zyrtarë të jenë angazhuar në punë dytësore.

6. Udhëzimi në nenin 42, paragrafi 3 përcakton që “i punësuarit mund të angazhohet në punë dytësore apo punë jashtë detyrës zyrtare maksimum 24 orë brenda javës, ose 96 orë brenda muajit”. Nga verifikimi i regjistrave të angazhimit të personelit në punë dytësore, është hasur një (1) rast kur zyrtari brenda javës ka tejkaluar limitin prej 24 orë të angazhimit në punë dytësore (rreshteri me nr. ID-6810 në javën e dytë të Nëntorit, në periudhën ndërmjet datave 11-17 është angazhuar 32 orë në punë dytësore). Tejkallim të numrit të orëve përtej limitit 96 orë në muaj nuk është hasur.

7. SPMK - Gjilan gjatë periudhës Tetor 2024 - Janar 2025 ka ofruar shërbime të sigurisë përmes punësimit dytësor në zbatim të një (1) Marrëveshjeje, e cila edhe ka qenë subjekt i inspektimit. Kontrolli i raporteve të punësimit dytësor pasqyron se shërbimet policore janë ofruar konform kushteve (numrit të angazhuarve dhe periudhave të angazhimit) dhe brenda afateve kohore të marrëveshjeve të arritura.

Përfundim

Bazuar në gjetjet e inspektimit rezultojnë se:

1. Një numër i konsideruar i punonjësve që kanë ofruar shërbime policore në bazë të Marrëveshjes së Policisë së Kosovës me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë, nuk kanë pasur vendime për punë dytësore nga Drejtoria e Personelit.
2. Raportet e ofrimit të shërbimeve të sigurisë të parapara me Marrëveshje, pasqyrojnë dallime thelbësore të përfshirjes së personelit në disa raste, duke ofruar mundësi jo

	<p>të barabarta të përfitimit nga puna dytësore, duke krijuar pakënaqësi për shkak të favorizimeve.</p> <ol style="list-style-type: none">3. Stacioni ka respektuar rregullat mbi kufizimet në përfshirjen e personelit në punë dytësore, që nënkupton se në angazhime të kësaj natyre nuk janë përfshirë policët e rinj në periudhë provuese dhe të liruarit nga sforcimet fizike.4. Në një rast të vetëm është gjetur që zyrtari i caktuar në punë dytësore ka tejkaluar numrin e orëve të lejuara brenda javës (mbi 24 orë), derisa numri i orëve të lejuara brenda muajit nuk është tejkaluar.5. Kushtet e parapara me Marrëveshjen e arritur ndërmjet palëve janë respektuar nga ana e Stacionit, kur kihet parasysh numri i të angazhuarve, periudha e angazhimit të tyre dhe afatet kohore (periudha e mbulimit).
--	--

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	IPK i rekomandon Komandantit dhe Shefit të Operativës të Stacionit Policor të Mbikëqyrjes së Kufirit - Gjilan, që të ushtrojë kontroll të duhur mbi drejtuesit që mbikëqyrin zbatimin e marrëveshjeve me organizatat dhe institucionet, për t'u siguruar se punonjësit angazhohen në punë dytësore, duke u bazuar në vendimet e lëshuara nga Drejtoria e Personelit.	-I-	Komandanti i Stacionit për Mbikëqyrje të Kufirit - Gjilan ka ngarkuar Shefin e Sektorit të Operativës së Stacionit për Mbikëqyrje të Kufirit - Gjilan, që të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm, në drejtim të një mbikëqyrjeje adekuate të punës dytësore, për t'u siguruar që personeli i angazhuar, të jetë i pajisur me vendime për punë dytësore.	Menjëherë
2.	IPK i rekomandon Komandantit dhe Shefit të Operativës të Stacionit Policor të Mbikëqyrjes së Kufirit - Gjilan, që të ushtrojë kontroll të duhur mbi drejtuesit që mbikëqyrin zbatimin e marrëveshjeve me organizatat dhe institucionet, në respektimin e parimit për trajtim të barabartë gjatë caktimit të personelit të interesuar në punë dytësore, drejt eliminimit të favorizimeve të mundshme.	-I-	Komandanti i Stacionit për Mbikëqyrje të Kufirit - Gjilan ka ngarkuar Shefin e Sektorit të Operativës së Stacionit për Mbikëqyrje të Kufirit - Gjilan, që të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm, me qëllim që personeli i angazhuar në punë dytësore të caktohet duke u respektuar parimi për trajtim të barabartë dhe eliminim të favoreve.	Menjëherë
3.	IPK i rekomandon Komandantit dhe Shefit të Operativës të Stacionit Policor të Mbikëqyrjes së Kufirit - Gjilan, që të ushtrojë kontroll mbi respektimin e rregullave të Udhëzimit Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, sa i përket orëve të lejuara brenda javës lidhur me angazhimin në punë dytësore.	-I-	Komandanti i Stacionit për Mbikëqyrje të Kufirit - Gjilan ka ngarkuar Shefin e Sektorit të Operativës së Stacionit për Mbikëqyrje të Kufirit - Gjilan, që të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm, për respektimin në plotëni të Udhëzimit Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, sa i përket orëve të lejuara brenda javës, lidhur me angazhimin në punë dytësore.	Menjëherë

Shtojca 1 - Lista e zyrtarëve policor të angazhuar në punë dytësore (numri i orëve të realizuara)						
ID	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Nëntor - Janar	Mesatarja
7221	8	0	0	0	0	0
2301	8	32	24	8	64	21
2130	0	0	32	16	48	24
4653	0	32	44	24	100	33
2608	0	0	0	24	24	24
7745	0	16	24	16	56	19
7781	24	32	40	16	88	29
6813	0	0	0	24	24	24
5577	8	40	32	40	112	37
8681	8	0	0	0	0	0
8773	0	32	16	24	72	24
2219	16	48	24	32	104	35
2597	24	48	40	64	152	51
6786	24	24	16	32	72	24
6172	0	32	24	24	80	27
1155	16	8	24	24	56	19
8859	8	48	40	24	112	37
7939	16	40	32	32	104	35
5369	16	40	48	32	120	40
6810	40	88	80	80	248	83
11563	0	0	0	40	40	40
7623	24	40	24	40	104	35
5734	24	48	48	48	144	48
7183	16	16	32	24	72	24
8748	0	16	32	16	64	21
7256	0	16	16	0	32	16
7502	0	24	24	32	80	27
7342	16	32	32	24	88	29
9349	0	0	0	32	32	32
7596	8	48	56	32	136	45
3310	16	40	16	32	88	29
4067	8	0	0	0	0	0
7087	8	56	24	24	104	35
3516	8	32	24	24	80	27
1348	8	40	32	24	96	32
6597	0	0	16	32	48	24
6487	8	32	24	16	72	24
2384	0	0	20	24	44	22
7415	0	0	32	24	56	28
9870	0	24	40	16	80	27
7255	8	32	40	24	96	32
6884	16	48	24	40	112	37
1255	16	0	8	24	32	16
11692	0	0	0	32	32	32
7007	0	48	32	16	96	32
5843	0	8	32	24	64	21
7375	16	32	32	16	80	27
3510	0	32	32	48	112	37
8855	16	32	24	24	80	27
8407	24	48	64	48	160	53
2042	0	40	52	56	148	49
7204	0	0	0	24	24	24
9777	16	8	24	16	48	16
4451	8	32	24	8	64	21
6436	0	0	0	16	16	16
6195	16	56	32	32	120	40
Gjithsej	496	1.440	1.452	1.488	4.380	32 orë

